

FJALA E DEPUTETES LINDITA METALIAJ

E ENJTE 10 NËNTOR 2022

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Jemi sot në ditën e dytë të seancës më të rëndësishme të vitit, ku diskutohet projektbuxheti i vitit 2023.

Në fakt, edhe dita e djeshme duhej të ishte një nga ditët më të rëndësishme për shqiptarët, por fatkeqësisht e filluam me Kryeministrin, i cili shpalosi fjalorin e rrugës, me një gjuhë banale, jashtë çdo norme dhe etike, por në asnjë fjalë të vetme nuk përmendi mirëqenien e familjeve shqiptare. U krenua për dyfishimin e buxhetit, krahasuar me vitin 2013. Në rregull, por a mund të më thoni, të nderuar kolegë, për sa kohë që është dyfishuar buxheti, pse nuk janë dyfishuar pensionet? Për sa kohë që është dyfishuar buxheti, pse nuk janë dyfishuar ndihmat ekonomike; pse nuk janë dyfishuar pagat e mjekeve, të infermierëve, të mësuesve dhe të pedagoqeve?

Pa dyshim, buxheti është rritur, pasi e kanë rritur politikat shkatërruese dhe aspak mbështetëse të arkitektit Rama.

A e dini se shqiptarët paguajnë çdo vit 500 milionë euro shtesë si pasojë e rritjes së taksave dhe 9 vjet kanë paguar 4,5 miliardë euro si pasojë e rritjes së barrës fiskale? Pra, ka rritur buxhetin për të arkëtuar më shumë para, duke i rritur me dyfish çmimet. Gjithashtu, ka rritur buxhetin, pasi ka marre 5 miliardë euro borxh shtesë, krahasuar me vitin 2013.

Të nderuar kolegë, a mund të më thoni sa e ul nivelin e papunësisë ky buxhet, sa e rrit cilësinë e arsimit dhe sa e përmirëson shëndetësinë ky buxhet? Pa dyshim që përgjigjja është një zero me xhufkë. Ky buxhet nuk ka prioritet as punën, as arsimin dhe as shëndetësinë.

Të dashur qytetarë,

Ju nuk jeni dhe as nuk keni qenë ndonjëherë prioritet i kësaj qeverie. Buxheti i shtetit është prova dhe dëshmia më e forte se si një qeveri qeveris, administron paranë publike, e cila në të vërtetë është para

private, pasuri private e qytetarëve shqiptarë, e njerëzve që punojnë dhe prodhojnë. Këtë pasuri ata ia japin shtetit që më pas u kthehet në detyra dhe në shërbime publike.

Si po i menaxhon qeveria “Rama” paratë e shqiptarëve? Sado që Kryeministri përrallis, vetë projektligji i buxhetit, që ai na ka paraqitur, e tradhton. Propaganda e ndihmon, por realiteti i hidhur dhe i trishtuar i njerëzve atje poshtë tregon të vërtetat e mëdha, të cilat janë krejt ndryshe.

Për ta konkretizuar: qëllimi i këtij buxheti, por edhe i të gjitha buxheteve të paraqitura nga Edi Rama në këtë parlament, është të marrë sa më shumë para nga xhepat e shqiptarëve dhe të arkëtojë sa më shumë në arkën e qeverisë.

Le t’u hedhim një vështrim të shkurtër: rritja e arkëtimit me 11% ose 180 milionë euro TVSH; rritja e arkëtimit, e tatimit, 7,6%, ose me 30 milionë euro; rritja me 12% ose e 50 milionë euro nga taksat kombëtare; rritja me 5,5% ose me 13 milionë euro nga taksat e pushtetit vendore e kështu me radhë.

Meqenëse jemi te pushteti vendor, dua të them dy fjalë: dje ministri i Drejtësisë, njëkohësisht, drejtuesi politik i qarkut të Lezhës, e përdori këtë foltore të parlamentit për t’i thurur lavde Bashkisë së Lezhës dhe foli për arritjet imagjinare që vetëm ai i shikon, duke lavdëruar “kryetarin 6%-sh” të Bashkisë së Lezhës. Për çfarë e lavdëroni, zoti Ministër? E lavdëruaka për lyerje dhe meremetime! Kaq ka bërë Bashkia e Lezhës: ka bërë lyerje dhe meremetime. Lyerjet dhe fshirjet e rrugëve apo prerja e ferrave janë detyrë e çdo komunaleje. Si drejtori komunaleje nuk janë edhe aq keq. Mendoj se si kryetari i ri që do të hyjë në bashki vitin e ardhshëm mund t’i propozojë që t’i mbajë si një ndërmarrje komunale, ndërsa si bashki nuk kanë as minimumin e konceptit se si menaxhohet dhe si drejtohet një bashki.

E gjithë politika e Bashkisë së Lezhës dhe e kryetarit ilegal është të bëjë blerje të disa elementeve nëpër fshatra, me mendimin se ata do ta ndihmojnë për të fituar zgjedhjet. Herën e parë e mori pa votë, ndërsa tani është ngushtuar laku, ka nisur ta mendojë ankthi i përballjes me votën, por, sado që të blejë dhe sado që t’i bojatisë fasadat, fitoren ta shikojë me teleskop, me dylbi jo që jo.

Arroganca e tyre do të marrë përgjigje shembullore më 14 maj 2023; tallja me qytetarët mbarë, por edhe me votuesit e Partisë Socialiste do të marrë faturën që meriton. Socialisti dhe ministri i Drejtësisë pa drejtësi nuk do të mundet ta shpëtojë nga fatura, që qytetarët e Lezhës, Kurbinit dhe Mirditës do t’ia japin bashkë me TVSH-në në zgjedhjet e 14 majit.

Le te rikthehemi përsëri te buxheti. Tek tabela që lexova janë mbi 300 milionë euro rritje të arkëtimeve, mbi 300 milionë euro shtesë u merren qytetarëve dhe bizneseve dhe shkojnë tek arka e Edi Ramës.

Pyetja është: a kthehen nga arka e Edi Ramës te qytetarët përsëri? Jo, paratë që u merren shqiptarëve, nuk u kthehen më shqiptarëve, sepse Edi Rama ka krijuar një mekanizëm, ka krijuar një magji të vjedhjes dhe të zhdukjes së parave të shqiptarëve, siç janë 430 milionë euro të vjedhjes galoponte të inceneratorëve apo 22 milionë euro të shëtitjeve me çarter. Në çdo vend normal, në çdo vend që funksionon me ligj dhe me Kushtetutë, jo me pushtet personal, buxheti do të hartohet për të krijuar performancë ekonomike dhe çlirim financiar.

Çfarë performance krijon ky buxhet në ekonominë shqiptare? Asnjë lloj performance.

Për ta konkretizuar me realitetin e Lezhës, zonës sime, ku 60% e popullsisë jetojnë në zonat rurale, merren me bujqësi dhe blegtori, mbijetojnë me shumë vështirësi dhe sigurojnë të ardhurat për familjet e tyre.

Një vendim i qeverisë suaj do t'ju japë 300 mijë lekë fermerëve që kanë mbjellë më shumë se 1 hektar tokë me grurë, ndërkohë që shumica e fermerëve nuk marrin asgjë, sepse kanë mbjellë më pak se 1 hektar tokë me grurë. Ju kujtoj se gruri mbillet tani në këtë periudhë, por korret pas 7 muajsh, ndërkohë që shpenzimet për të mbjellë 1 parcelë me grurë janë afro 1 milion lekë. Nga kjo parcelë prej 1 hektarësh ata do të marrin 50 quintalë grurë. 1 kilogram grurë kushton 400 lekë, pra në total të ardhurat janë 2 milionë lekë, duke zbritur shpenzimet me 1 milion lekë, në fund ajo çfarë mbetet në xhepin e fermerit janë vetëm 1 milion lekë të vjetër. Po t'i ndajmë këta 1 milion lekë në 7 muaj punë, mund dhe djersë të të gjithë familjes, janë vetëm 140 mijë lekë në muaj. Tani pyetja ime është: a ia vlen gjithë ky mund dhe gjithë kjo sakrificë për vetëm 140 mijë lekë në muaj?

A mund të mbijetojnë ato familje duke u ushqyer me vetëm 140 mijë lekë në muaj, madje në shumë raste ky fitim mungon, pasi ka përmbytje në zonat e Torovicës, të Zadrimës, Bregut të Matit e të tjera?! Kjo është edhe arsyeja pse tokat mbeten djerrë, sepse nuk ia vlen munda e sakrifica për një fitim minimal.

Mund t'ju jap edhe raste të tjera: fermeri Nikë Gilaj nga Zejmeni i Lezhës, para 7 vjetësh bashkë me dy djemtë e tij mbollti 12 dynymë tokë me shegë, por mungesa e tregut dhe fitimi i ulët bëri që prodhimet të kalbeshin në arë dhe dy djemtë e tij të largoheshin në emigrim, duke ia shtuar edhe më shumë shpenzimet, hallet dhe vështirësitë familjes Gilaj. Fermeri Gjini Marku nga Troshani i Lezhës ka 200 rrënjë ullinj. Ai thotë që nuk ka treg për shitje, si për ullinjtë, ashtu edhe për vajin e ullirit. Nuk ka vaditje, ka kosto të lartë për mirëmbajtje. Çmimet e larta të pesticideve, çmimi i lartë i karburantit bënë që prodhimet t'i mbajnë deri në 1 vit dhe më pas detyrohen t'i falin, ose t'i hedhin.

Gjithashtu, fermeri Lazer Preçi ka 25 vjet që merret me kultivimin e ullinjve dhe sot e shikon që nuk ia del. Si këta, janë edhe shumë të tjerë, por duhet të rrimë deri nesër në mëngjes t'i përmendim emër për emër. Sikur të mos mjaftonin vështirësitë në treg dhe në mirëmbajtje, këtyre fermerëve u janë larguar fëmijët nga shtëpitë. Emigracioni, ikja masive, shpopullimi dhe braktisja e Shqipërisë sikur të ishim në luftë apo në prag katastrofë, është një tjetër tragjedi kombëtare.

Pyetja ime, por edhe e çdo shqiptari tjetër është: ky buxhet që keni sjellë, a e ndalon apo e parandalon sadopak shpopullimin? Jo, sepse nuk jep asnjë mundësi. Ky buxhet që keni sjellë, a e ndihmon rritjen e prodhimit vendas dhe a ndihmon për hapjen e tregjeve dhe çlirimin financiar të ekonomisë shqiptare? Jo, sepse nuk jep asnjë mundësi.

Ky buxhet nuk është as për ekonominë, as për institucionet, as për çlirimin financiar, as për drejtësinë, as për arsimin, as për shëndetësinë dhe për asgjë tjetër.

Ky është një buxhet që Edi Rama e harton për veten, për oligarkët e tij, për klientelën e tij, sepse ai i ushqen me tenderë; e harton për bandat elektorale të partisë, sepse vitin e ardhshëm janë zgjedhjet. Nuk është një buxhet i shqiptareve dhe për shqiptarët, edhe pse janë taksat, tatimet, puna, djersa, mundi dhe sakrificat e tyre, që punojnë për të mbajtur familjet e tyre, por për të mbajtur edhe shtetin në këmbë. Të gjithë këtë mund, të gjithë këtë sakrificë dhe të gjithë këtë përkushtim të sipërmarrësve të Shqipërisë Edi Rama ua merr dhe ua shpërndan të gjithë oligarkëve dhe bandave elektorale. Në realitet kjo është një vjedhje e pastër që u bëhet qytetarëve nga qeveria e Ramës, por në një vend, ku do të mbizotëronte ligji dhe shteti ligjor kaq do të mjaftonte që kjo qeveri të mos rrinte më asnjë ditë të vetme në pushtet. Faleminderit!